

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KRUJË  
KESHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr 102 Date 03/05/2017

**Për “PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS DHE RRETHQYTETËS TË UDHËTARËVE NË BASHKINË E KRUIJES, MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT DHE PËRCAKTIMIN E STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË AUTOBUSËVE TË SHËRBIMIT NË KËTO LINJA”**

Këshilli i Bashkisë Krujë ne mbledhjen e tij te dates 03/05/2017, Në zbatim Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar), Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugor (ndryshuar); udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 për “Kriteret dhe procedurat për lëshimin të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuarsi dhe relacionit te pregatitur nga Bashkia Kruje:

**VENDOSI:**

1-Të miratojë rrjetin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve në Bashkinë e Krujes.

**Linja Nr. 1 Fushe Kruje – Thumane – Fushe Kruje**

**Linja Nr. 2 Nikel – Thumane – Nikel**

**Linja Nr. 3 Bubq – Thumane – Bubq**

**Linja Nr. 4 Thumanë - Fshatrat:** Koder Thumane –Fushe Thumane, L4/1 Kocer Derven – Fushe Derven, L4/2 Burizane, L4/3 Gramez, L4/4 Bushnesh, L4/5 Sul Vendas, L4/6 Dukagjin i Ri, L4/7 Arest Miliska

**Linja Nr. 5. Bubq – Nikel – Bubq**

**Linja Nr.6 Nikel – Fshatrat:** Nikel, L6/1 Rinas, L6/2 Qereke, L6/3 Tapize, L6/4 Zeze, L6/5 Verjon, L6/6 Grepse, L6/7 Bura, L6/8 Kurcaj, L6/9 Mukje

**Linja Nr.7 Fushe Kruje – Bubq – Fushe Kruje**

**Linja Nr.8 Bubq – Fshatrat :** Bubq, L8/1 Budull, L8/2 Mazhe e Madhe, L8/3 Mazhe e Vogel, L8/4 Mallkuc, L8/5 Murqine, L8/6 Bilaj

**Linja Nr.9 Kruje – Cudhi – Kruje**

**Linja Nr.10 Cudhi – Fshatrat :** Cudhi Qender – Cudhi Kampt L10/1 Nuaj, L10/2 Mafsheq, L10/3 Shqeze, L10/4 Shkrete, L10/5 Kroji i Madh, L10/6 Bruz M, L10/7 Bruz Zalle, L10/8 Rraze

**Linja Nr.11Kruje – Fshatrat :** L11/1 Barkanesh, L11/2 Dane Fushe Madhe, L11/3 Picrrage, L11/4 Brret

**Linja Nr.12 Fushe Kruje – Fshatrat :** L12/1 Zalle, L12/2 Larushk, L12/3 Arrameras, L12/4 Halil, L12/5 Luz

2-Stacionet e ndalimit të linjave rrethqytetëse do jenë në parim 500 m – 1000 m distancë nga njëra – tjetra.

3-Orari i fillimit dhe mbarimit të shërbimit për linjat rrethqytetëse në periudhën Prill – Tetor do të jetë nga 05.00 – 23.00, dhe 05.30 – 22.30 për periudhën Nëntor – Mars, me orare lëvizje jo më shumë se 15 – 20 min në orët e pikut.

4-Kushtet teknike të komoditetit dhe sigurisë që duhet të plotësojnë mjetet e transportit rrethqytetës janë:

a. Transporti rrethqytetës i udhëtarëve mund të bëhet vetëm me mjete të destinuar për transport udhëtarësh, me numër vendesh ulur dhe në këmbë të përshtatshme për transport rrethqytetës.

- b. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dritare emergjence funksionale. Pozicioni dhe mënyra e përdorimit të tyre u behet e njohur udhëtarëve, nëpërmjet mbishkrimeve mbi to.
- c. Dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga shoferi në mënyrë automatike.
- d. Estetika e brendshme (lidhur me vendet e pasagjerëve, dritaret, dyshemetë e mjeteve etj.), që konsiston në drejtim të një paraqitjeje dhe mirëmbajtjeje sa më të pranueshme e cila respekton në këtë mënyrë kërkesat e komunitetit për një shërbim të një cilësie të lartë, do të jetë e detyrueshme për të gjitha mjetet.
- f. Estetika e jashtme e të gjitha mjeteve do të jetë e tillë që të plotësojë rregullat në zbatim të Kodit Rrugor lidhur me vendosjen mbi mjetet e transportit të shkrimeve a shenjave reklamuese të shndritshme ose reflektuese, me qëllim që të përjashtohet çdo rrezik verbimi a hutimi për drejtuesit e mjeteve të tjera dhe njëkohësisht të pengojë çdo formë reklamimi që ka një përmbajtje, domethënie apo synim të kundërt me normat e këtij Kodi.
- h. Dritaret duhet të jenë funksionale dhe të mos zihen nga reklama.
- i. Të jenë të pajisur me kuti të ndihmës së shpejtë shëndetësore.
- j. Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të jene të veshura, ne gjendje te mire për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm.
- k. Ngjyra e mjeteve në një linjë duhet të jetë uniformë.
- Për linjat që lidhin fshatrat me njëra – tjetrën, fshatrat në drejtim të qendrës së njësisë administrative që i përkasin/ ose një njësie tjetër të së njëjtës bashki, lejohet përdorimi i mjeteve (8+1).

5-. Për ndjekje dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Kruje.

6-. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit per bazueshmeri ligjore nga Prefekti I Qarkut Durres.

**Kryetari i Keshillit te Bashkisë**

**Hysni Caca**

